

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(-II ad Cor. III, 17-).

1. Ligja	Fq. 505
2. Kundra nji blasfemis së fletores „Bashkimi“	524
3. Halil Garria	534
4. Kanûni i Lekë Dukagjinit	549
5. Trashigime Thrako-ilirjane	551
6. Fjalë Popullore të pershtatuna vendeve të ndryshme të Shqypënis	555
7. Bibljografi	558

SHKODER
Shtypshkroja Franciskane
1924.

Ligja*

Ç' është Ligja!

Tue thënë se „Ligja“ është përmbledhja organike e kushteve të besës që lidhë njerzit që i shtrohen njëj flamuri e përbajnë një organizëm politike e shoqënore — na duket se u qindrojmë besnikë parimevet më të pranueshme në lamë të dijes juridike.

Ciceroni thotë se „Ligja është arsya më e naltë që buron prej natyrës, që urdhnon ato punë që janë të mira e ndalon të përkundertat“ 1).

Montesquieu, që me librin „De l'Esprit des Lois“ — Shpirti i Ligjëvet — u bërë parë-prisi i sociologjis së shoqme, dhe temeluesi e caktuesi i parimevet të sundimit liberal — i quen ligjët „les rapports nécessaires qui dérivent de la nature des choses“ 2) e thotë se ato janë të lidhuna me natyrën dhe formen e qeveris, me fizikën e vendit, me klimën e ftoftë, e butë ose e zëhtë, me cillsin e tokës, me fën e popullit, me të prirunit, me pasunin, me tregtin, me sasin e popullsis; elementa këto që përbajnë shpirtin e ligjëvet.

Neve këto fjalë munden me na mjaftue që të dijmë

* Me këto shkrime, e sidomos me shenimet që i përkasin enciklopedis juridike, na nuk paraqesim një artikull për rivistë juridike, por disa mendime të rreshtueme për popullin. **T. T.**

